

Projekti “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”

PROGRAMI I MONITORIMIT WATCH-DOG DHE STRATEGJIA E ADVOKIMIT

Lenda:

| | | |
|----|--|----|
| A. | Programi i monitorimit watch-dog..... | 3 |
| | Hyrje | 3 |
| 1. | Pershkrimi i përmbledhur i problematikave të zgjedhura..... | 3 |
| 2. | farë synon Programi i monitorimit?..... | 5 |
| 3. | Pse duhet Monitorimi?..... | 6 |
| B. | Strategjia e advokimit | 8 |
| | për problematikat e prioritetuara nga rrjeti “Mbrojme ekosistemin Kune Vain Tale..... | 8 |
| 1. | Problematika e zonës: | 8 |
| 2. | Cili është problem kryesor që keni përzgjedhur për të advokuar në zonën tuaj të projektit?. | 8 |
| 3. | Literatura e grumbulluar për argumentimin e qëllimit të fushatës advokuese..... | 9 |
| 4. | Mesazhi i fushatës tuaj advokuese..... | 10 |
| 5. | Grupi i aktorëve tek i cili do të shkojë mesazhi i fushatës tuaj advokuese..... | 10 |
| 6. | Grupi i aktorëve që keni përzgjedhur t’ju mbështesë në fushatën tuaj advokuese | 11 |
| 7. | Aktivitetet që keni identifikuar për zbatim gjatë fushatës tuaj advokuese që do të shërbejnë për zbatimin e strategjisë dhe shpërndarjen e mesazhit në grupet e targetuara | 11 |
| 8. | Kalendari i zbatimit të aktiviteteve dhe produktet që do të nevojiten për fushatën ose angazhimin e aktorëve kyç..... | 12 |
| 9. | Angazhimi i mediave në fushatë..... | 13 |

A. Programi i monitorimit watch-dog

Hyrje

Programi i monitorimit hartohet në kuadër të zbatimit të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe në bashkëpunim të ngushtë me INCA .

Ky program është produkt i punës shumëplanëshe të KEL dhe rrjetit MEKVT për identifikimin e problematikave mjedisore për çdo NjA të BL, vleresimin e prioritarizimin e tyre. Ky program është fokusuar në dy problematikat kryesore të prioritarizuara dhe do të shërbejë si bazë për ndertimin e strategjisë së advokimit.

Dy nga problemet kryesore që kemi përzgjedhur për të monitoruar e advokuar në zonën e projektit, janë:

- A. Ndotja e zonës së mbrojtur KVT nga mbeturinat urbane (në të cilat dominojnë mbetjet plastike), ndikimi ekologjik e social ekonomik prej saj.
- B. Degradimi ekstrem i lumit Drin nga mungesa e rrjedhjes ujore ashtu dhe niveli i ndotjes së tij.

1. Pershkrimi i përmblodhur i problematikave të zgjedhura

Problematika A.

Megjithë permirsimet e dukshme në drejtim të administrimit të mbeturinave urbane në zonën e mbrojtur KVT, përsëri në mjaft vatra të saj verëhen shkarkime të ketyre mbeturinave dhe mbi të gjitha një sasi e konsiderueshme arrin përmes rrjetit hidrik. Kështu vatra me e ndotur është ajo e grykederdhjes së lumit Drin, e cila përfshin të dy brigjet e tij si dhe mjaft e theksuar kjo situatë në anën veriore të kesaj grykederdhje, në litoralin midis detit Adriatik dhe lagunës së Merxhanit. Po ashtu në veçanti mbetjet plastike takohen në të gjithë zonën e plazhit dhe në mjedisin shkurror e ligatinor në afërsi të tij, në ujrat e hidrovoreve e magjistralet kulluese etj. Kjo problematike është e lidhur me ndotjet në tërësi të të gjithë rrjetit hidrik të BL, e cila reflekton edhe në zonën turistike të ekosistemeve të rezervatit natyror Kune Vain Tale. Një sasi e konsiderueshme e mbetjeve plastike vijnë nga deti të shkarkuara nga lumi Ishëm, në zonën e Godulles.

Rishikimi i skemes së evadimit të mbeturinave nga BL, në favor të zgjerimit të saj, duhet të synojë parandalimin e ndotjes që në burim në çdo njësi administrative, rritjen e kontrollit dhe të masave ndeshkuese ndaj ndotesve, bashkëpunimi i gushtë i AdZM-së me Institucionet e BL dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese.

Advokimi i çeshtjeve që kanë të bëjnë me krijimin e një sistemi të mirëadministrimit të mbetjeve në zonën e mbrojtur, të pasqyruar e propozuar në planin e menaxhimit të rishikuar, zbatimin e masave pilote që ndergjegjesojnë aktoret e interesuar dhe agjensitë ligjzbatuese, për pakësimin e nivelit të ndotjes e vendosjes e situatës nënkontroll deri në arritjen e objektivave për respektimin e standarteve mjedisore ligjore.

Rritja e vatrave me mbetje plastike brenda zonës së mbrojtur, rritja e prurjeve ndotese (ujrate zeza dhe veçanerisht mbetjet plastike) në rrjetin hidrik që komunikon me zonën e mbrojtur, kanë krijuar një situatë të paprecedentë ndotjeje të ekosistemeve të zonës së mbrojtur, duke ndikuar ndjeshëm në degradimin e ekosistemit, rritjen e nivelit eutrofik në sistemin lagunor, uljen e vlerave të pejsazhit. Kjo situatë është mjaft e rëndësishme edhe në zonën buferike dhe me gjërë dhe e ndikuar prej tyre.

Duke pasur parasysh dhe ndjeshmerinë e zonës nga ana mjedisore, dhe sidomos ekspozimin e madh të saj nga prania e efekteve të ndryshme klimatike këto masa duhet të jenë prioritare e me një spektër të gjërë përfitimesh jo vetëm të zonës së mbrojtur natyrore por dhe më gjërë.

Problematika B.

Mungesa e rrjedhjes së gjallë ujore në lumin Drin në rreth 80 % të kohës vjetore, rritja e nivelit të ndotjes nga ujrat e zeza dhe mbeturinat urbane kanë rritur në mënyrë kritike shkallën e degradimit tërësor të këtij lumi, i cili konsiderohet si lum i vdekur ose thjesht si magjstral kullues pothuajse mosfunksional.

Kjo problematike, është e shprehur me ndikimet të mëdha në rritjen e shkallës së ndotjes së ujrave të lumit Drin, dhe të gjithë sistemit lagunor KVT, dhe rritjen e rrishtit për përmbajtje masive të zonës së Zadrimës, të qytetit të Lezhës e shumë më gjërë.

Nga viti 2005 e në vijim, një sërë aktiviteteve kërkimore shkencore, monitoruese, ngjarjet klimatike me përmbajtje etj e kanë konfirmu plotësisht nevojën e trajtimit sa më të plotë e të thelluar të zgjidhjes së kësaj problematike. Në kuader të projekteve, është arritur të llobohet nga KEL e shoqatat e tjera të Lezhës, në nivel lokal, rajonal e deri tek dikasteret qendrore, por ajo që është arritur deri tani është dakordësimi me vendimarrësit, për mundësimin e rivitalizimit të lumit Drin të Lezhës, duke risjellur te pakten minimalisht prurjet në shtratin historik të tij.

Nepermjet prioritarizimit të kësaj problematike, KEL dhe rrjeti MEKVT, jo vetëm që mban të gjallë frymen e kësaj dakordësie të arritur ndër vite, por do të lloboje me fuqishëm për të futur problemin në rrugën e zgjedhjes.

Zgjidhja e këtij problemi lidhet me përfitime multidimensionale jo vetëm të natyrës mjedisore natyrore por dhe ato me natyrë të theksuar sociale dhe ekonomike.

2. Çfarë synon Programi i monitorimit?

Programi i monitorimit për dy problematikat kryesore ka si synim të sigurojë e administrojë të dhëna si nga në terreni ashtu dhe nga aktiviteti i Institucioneve të tjera kërkimore e shkencore, botimet e rezultateve të tyre për të adresuar zgjidhje e rekomandime konkrete për t'i bërë objekt të strategjisë së advokimit.

Ky program ka keto objektiva kryesore:

- Të masë ndikimet e tanishme e ato afatgjata social ekonomike dhe ekologjike në zonën e mbrojtur KVT, që lidhen me administrimin e mbeturinave, kryesisht ato plastiket.
- Të masë ndikimet e tanishme e ato afatgjata social ekonomike dhe ekologjike në zonën e mbrojtur KVT, që lidhen me degradimin e lumit Drin të Lezhës dhe rivitalizimin e tij.
- Te bashkëpunoje e të shkëmbeje të dhëna me studentet e shkencave të natyrës dhe studiusit e hidrologjise dhe gjeomorfologjise.
- Një plan për vazhdimin e monitorimit nga AdZM pas përfundimit të projektit.
- Shperndarjen e rezultateve të monitorimit tek strukturat përgjegjese relevante.
- Kjo program do të lejojë zhvillimin e raporteve teknike që përshkruajnë rezultatet e monitorimit dhe është në përputhje me objektivat e aktivitetet e planit të menazhimit egzistues për këtë zonë.

Protokollet e monitorimit që duhet të kryhen nga KEL e rrjeti MEKVT në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Agjencisë Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) për të matur ndikimet socio - ekonomike dhe ekologjike.

3. Pse duhet Monitorimi?

Habitatet bregdetare dhe ato të grykëderdhjes dallohen për produktivitetin dhe biodiversitetin e tyre të lartë, ato janë themeli i rrjetës ushqimore të grykëderdhjes. Kur shyrtojmë ndotjen si nga mbeturinat urbane ashtu dhe ujrat e zeza si dhe ne kuadrin e skenareve të ndryshimeve klimatike, duhet të kemi parasysh:

- Ndotja nga mbeturinat dhe ujrat e zeza do të ndikojë në ekosistemet bregdetare që tashmë janë modifikuar shumë nga njerëzit
- Ndërveprimet ekologjike janë shumë dinamike: ato ndryshojnë në mënyrë hapësinore dhe kohore brenda zonës bregdetare të ndikuara fuqishëm nga presion i faktorit antropogjen.
- Spektri i gjerë i rezultateve të ndikimeve nga ndotjet; ne kemi nevojë për njohuri më të mëdha dhe aftësi parashikuese në këtë drejtim
- Ndikimet ndotese përgjatë zonës bregdetare janë më të theksuara nga ekspozimi i lartë i kesaj zonë nga efektet e ndryshimeve klimatike.
- Të dhënat sasiore analitike nga monitorimi shërbejnë si bazë argumentimi për zhvillimin e strategjisë së advokimit

Table 1. Të dhena mbi pikat e monitorimit të mbetjeve urbane dhe të cilësisë së ujit për zonën e mbrojtur KVT.

| Emri i kundodhet stacioni | Kodi i stacionit | Informacioni per stacionin | Lartesia gjeografike e stacionit (Sistemi WGS84) | Gjeresia gjeografike e stacionit (Sistemi WGS84) | Sasia e mbetje plastike Kg/50m ² | Cilesia e ujrave siperfaqesor e ¹ |
|----------------------------|------------------|--|--|--|---|--|
| Grykederdhja lumit Drin | G1 | Pjesa jugore fundore grykederdhjes se Lumit Drin | 41° 45' 00" N | 19°34'21" E | | |
| Hidrovorit Ishull Shengjin | H1 | Zgara mbledhese e Hidrovorit në Ishull Shëngjin | 41° 46' 19" N | 19°36'330" E | | |
| Hidrovorit Tale | H2 | Zgara mbledhese e Hidrovorit në Tale | 41°42' 37" N | 19° 35' 12" E | | |
| Zaje, kanali i komunikimit | Z1 | Zaje, kanali komunikimit | 41°45' 00" N | 19° 34' 30" E | | |
| Lezhë | L1 | Qyteti Lezhë, magjistrali kullues ne anë të rrugës Shtraus | 41°46' 28" N | 19° 38' 28" E | | |
| Tale | T1 | Shkarkimi i magjistralit nga Gajushi direkt ne det (Tek ura) | 41°41' 08" N | 19° 35' 17" E | | |

¹ **BURIMI I TË DHËNAVE** • Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
 • Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
 • Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

B. Strategjia e advokimit

për problematikat e prioritizuara nga rrjeti “Mbrojme ekosistemin Kune Vain Tale

1. Problematika e zonës:

(përshkruani problemet që ka zona ku po zbatoni projektin dhe që i keni identifikuar si pjesë të punës tuaj gjatë zbatimit tëprojektit)

Ndotja e zonës së mbrojtur KVT nga mbeturinat urbane (në të cilat dominojnë mbetjet plastike), ndikimi ekologjik e social ekonomik prej saj.

Degradimi ekstrem i lumit Drin nga mungesa e rrjedhjes ujore ashtu dhe niveli i ndotjes se tij. Ndikimi shumplanesh degradues i zones Kune Vain Tale si dhe shumë më gjërë nga nderpreja prej dekatash e prurjeve natyrore te ujrave te lumit Drin dhe i shkarkimeve ndotese ne të. Niveli i larte i ndotjes dhe rritja e eutrofikimit të sistemit ligatinor KVT

Niveli i ulët i njohjes se kërkesave të planit të menaxhimit të zonës KVT, legjislacionit për zonat e mbrojtura, të vlerave natyrore e menaxhimin e integruar të burimeve natyrore të zonës si dhe të ndergjegjesimit për mbrotjen e saj, të organeve të vetëqeverisjes vendore, komunitetit lokal, nxenesve të shkollave, subjekteve turistike, turisteve frekuentues etj.

Mungesa e rishikimit të planit te menaxhimit per zonën Kune Vain Tale.

Zbehtesia e pasiviteti për zbatimin e kërkesave për përdorimit e qëndrueshëm të burimeve natyrore te ekosistemit te rezervatit natyror Kune - Vain - Tale nga Komiteti i Menaxhimit të kësaj zone, Bashkia e Lezhës e Njesitë Administrative të saj.

Niveli i ulët e trajtimit e advokimit nga media të çeshtjeve që lidhen me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore te ekosistemit te rezervatit natyror Kune - Vain - Tale, mungese partneritetit të medias me organizatat për mbrojtjen e natyres.

2. Cili është problem kryesor që keni përzgjedhur për të advokuar në zonën tuaj të projektit?

(përshkruani me fjalë cili është problem kryesor që ju mendoni se mund te zgjidhni me fushatën tuaj të advokimit)

- Ndotja e zonës së mbrojtur KVT nga mbeturinat urbane (në të cilat dominojnë mbetjet plastike), ndikimi ekologjik e social ekonomik prej saj.

3. Literatura e grumbulluar për argumentimin e qëllimit të fushatës advokuese

(jepni të listuar materialet shkencore, informative apo ligjore mbi të cilat keni ngritur argumentet për fushatën tuaj advokuese).

Plani i menaxhimit të zones Kune Vain Tale, 2010, CEIA;

Raporti i Gjendjes e Mjedisit 2018, 2019, 2020, AKM, Tiranë;

Plani i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë e Lezhës;

Strategjia territoriale, Bashkia Lezhë;

VSM Bashkia Lezhë.

Bay of Drini integrated territorial planning study, Incorporating Strategic Environmental Assessment, November 2006, JeJacobs.

Medwet Technical report, ECAT Tirana, 1998;

Konferenca Shkencore per zhvillimin e Lezhës, Lezhë 2005;

Botimet e raportet e KEL për situatën e mjedisore në zonë si:

- Hartimi dhe botimi i broshures “Ndikimet e lumit Drin në ekosistemet e Kune Vain Tale”, në kuadrin e zbatimit të projektit “Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore te ekosistemit te rezervatit natyror Kune - Vain - Tale” mbeshetur nga INCA, 2020.
- Studimi e botimi i broshures “Menaxhimi i qëndrueshëm i Ekosistemit e Kune Vain Tale”, i përgatitur nga në kuadrin e zbatimit të projektit “Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore te ekosistemit te rezervatit natyror Kune - Vain - Tale” mbeshetur nga INCA, 2021.
- Sherbimi i ekspertizes së KEL : “Raport mbi rishikimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur KVT”, 2019, i cili skanon në mënyrë të detajuar të gjithë permbajtjen e planit, zerat e zbatuar nga ky plan, problematikat në implementimin e tij, konsultat me aktorët relevant, argumenton nevojat e rishikimit të plotë të ktij plani e i adreson këto çeshtje tek institucionet pergjegjese.

4. Mesazhi i fushatës tuaj advokuese

(formuloni mesazhin që do të përcjellë fushata juaj e advokimit)

Sipas ecurisë së fushatës, periudhës kohore dhe komunitetit të përfshirë, fushata e advokimit do të përcjellë mesazhet:

- Parandalojme së bashku mbetjet plastike
- Thuajini lamtumirë plastikes me një përdorim
- Jo ma qeska plastike
- Shmangni plastikat një përdorimshe
- Jo plastikes
- Stop ndotjes plastike
- Thuaji jo plastikes
- Te mbrojmë ujin e detit nga plastikat
- Ndal ndotjes së ujit
- Jo mbetje në mjedis
- Ndal ndotjeve në mjedis

5. Grupi i aktorëve tek i cili do të shkojë mesazhi i fushatës tuaj advokuese

(përshkruani grupin e aktorëve që ju keni targetuar për të përcjellë mesazhin tuaj të fushatës që të ndikojnë në zgjidhjen e problemeve që keni identifikuar për fushatën tuaj)

Përfaqësues e drejtues nga:

- Rrjeti MEKVT
- Bashkia e Lezhës,
- Prefektura e Lezhës.
- AdZM Lezhë

- AKZM, Tiranë
- Ministria e Turizimit dhe e Mjedisit
- Qarku i Lezhës.
- Agjensia e Kombetare e Bregdetit (dega e Lezhës)(AKB).
- DRM Lezhë.
- Komuniteti i zonës

6. Grupi i aktorëve që keni përzgjedhur t'ju mbështesë në fushatën tuaj advokuese

(përshkruani grupin e aktorëve që ju keni targetuar për t'i pasur si mbështetës në fushatën tuaj që të ndikojnë në zgjidhjen e problemeve që keni identifikuar për fushatën tuaj)

- Kryetari i Bashkisë së Lezhës në bashkëpunim me ekspertet e kabinetit.
- Përfaqesues të biznesit të Lezhës, (ne veçanti të zonës turistike bregdetare).
- Shoqatat, organizatat, grupimet e rrjetetizimet e shoqërisë civile të Lezhës, si ato ambientaliste (tre), shoqatat e grave, shoqatat e romëve (dy), e shëndetësive, e gazetareve etj.
- Stafi i AdZM-së Lezhë.
- Prefekti i Qarkut të Lezhës me specialistet e tij.
- Përfaqesues të tjere nga Nj A.

7. Aktivitetet që keni identifikuar për zbatim gjatë fushatës tuaj advokuese që do të shërbejnë për zbatimin e strategjisë dhe shpërndarjen e mesazhit në grupet e targetuara

(përshkruani aktivitetet që keni përcaktuar të zhvilloni gjatë fushatës në shërbim të angazhimit të grupeve të targetuara si mbështetësit tuaj dhe si grupin ku duhet adresuar mesazhi i fushatës advokuese)

- Raporti i vleresimit të problematikave të territorit të bashkisë së Lezhës, Angazhim ekspertize Prill – Maj 2022.

- Raporti i hartuar, përveç se do të argumentojë nevojën emergjente të ndalimit të shkarkimeve të mbeturinave urbane në zonë si dhe në rrjetin hidrografik, do të parashtrijë dhe rekomandimet si dhe planin e veprimit për mirëadministrimin e mbetjeve e respektimin e standarteve për të gjitha NjA e BL, e në veçanti për zonën e mbrojtur KVT. Ky aktivitet ka pjesmarrjen dhe mbështetjen direkte të AdZM, Komitetin e Menaxhimit, mbështetjen e AKZM, e të aktorëve të tjerë lokal.

Në këtë kuadër do të bëhen takime me Drejtorinë përkatëse në Bashkinë Lezhë, si dhe me kryetarin e Bashkisë për gjetjen e një zgjidhjeve për përfshirjen në rrjetin e pastrimit dhe të pikave të caktuara brenda zonës së mbrojtur Kune e Vain.

- Paketa informuese mbi përgjegjësitë e Pushtetit Vendor dhe të drejtat e publikut për transparencën dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

Nepermjet hartimit dhe shpërndarjes së kësaj pakete, Institucionet lokale dhe Agjensitë ligjzbatuese do të fokusohen për një njohje me të mirë të kërkesave të legjislacionit mjedisor veçanërisht në drejtim të administrimit të mbetjeve, për të rishikuar e u ndergjegjesuar në rritjen e kapaciteteve në zbatimin e ketyre kërkesave. Nepermjet tyre do të fuqizohet advokimi për arritjen e rezultateve.

- Në vijim të këtij aktiviteti do të ketë ture me gazetaret e mediave lokale e kombetare në zonën e mbrojtur KVT, shoqëruar me një konferencë për shtyp në natyrë. Këtu do të advokohen në mënyrë paresore dhe çështje të fokusuar sipas synimeve të strategjisë së advokimit.
- Rrjeti MEKVT do të synojë bashkëpunimin me gazetaret për realizimin e Kronikës televizive mbi rezultatet nga projekti në zbatim i cili do të trajtojë dhe çështjen për advokim që lidhen me sfidën për të krijuar një mentalitet e sistem të qëndrueshëm për rehabilitimin e mirëmbajtjen mjedisore të KVT, në veçanti eliminimit të mbetjeve plastike. Pasqyrimi në media do të jetë zëri i shumë aktorëve për advokimin e çështjeve specifike për ringritjen e KVT në drejtim të mirëmenaxhimit të saj për mirëadministrimin e mbetjeve.

8. Kalendar i zbatimit të aktiviteteve dhe produktet që do të nevojiten për fushatën ose angazhimin e aktorëve kyç

(jepni kalendarin e shtrirë në kohë për fushatën duke e përputhur me aktivitetet e identifikuar për zbatim. Përshkruani cilat produkte ju nevojiten në çdo aktivitet të përcaktuar)

| Aktiviteti | Koha e zbatimit | Materialet e nevojshme |
|--|---|--|
| <p>Raport mbi identifikimin e problematikave mjedisore në nivel NjA, vleresimin e prioritarizimin e tyre. (Angazhim ekspertize).</p> <p>Inspektime në NjA, realizimi i pyetsoreve në kete nivel, e analizimi i rezultateve. Takime me subjektet relevante, inspektime ne terren per mbetjet.</p> | <p>Prill – Maj 2022</p> <p>Prill 2022</p> | <p>Raport i drejtuar Institucioneve ligjezbatuese.</p> |
| <p>Hartimi e shperndarja e Paketës informuese mbi përgjegjësitë e Pushtetit Vendor dhe të drejtat e publikut për transparencën dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.</p> | <p>Maj 2022</p> | <p>Materiali i printuar do t'u shperndahet të gjithë aktoreve që lidhen direkt ose indirekt me administrimin e burimeve natyrore e situaten mjedisore ne teresi.</p> |
| <p>Bashkëpunimi me median ne pasqyrimin e rezultateve të aktiviteteve të kryera zonen e mbrojtur KVT shoqeruar me nje konference per shtyp ne natyre.</p> | <p>Qershor 2022</p> | <p>Deklarate per shtyp (edhe e shkruar) mbi situaten mjedisore qe i shperndahet gazetaresve Prodhimi i lajmeve per situaten mbi mbetjet e ndotjet qe ndikojne direkt ne KVT.</p> |

9. Angazhimi i mediave në fushatë

(përshkruani në cilat aktivitetet media do të jetë e pranishme dhe çfarë materiali do të përdoret për promovimin e aktivitetit apo të fushatës)

Media do te jete e angazhuar direkt ne:

Pasqyrimin e inspektimeve të kryera dhe kryerjen e aktiviteteve te monitorimit ne zonen e mbrojtur KVT (me gazetaret e mediave lokale e kombetare) në menyre të veçantë në sensibilizimin e komunitetit në ndalimine shkarkimeve të mbeturinave në mjedis, në mënyrë të veçantë të atyre plastike, shoqeruar me konference per shtyp ne natyre. Ketu do te advokohet ne menyre paresore dhe çeshtja e e fokusuar per advokim.